



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
Kuvendi Komunal – Skupština Opštine – Municipal Assambly
JUNIK

Rregullorja Komunale nr.4/2009

RREGULLORE PËR PËRDORIMIN E GJUHËVE NË KOMUNËN E JUNIKUT

*Junik
Korrik , 2009*

Në bazë të neneve 9, 11 dhe 12(c) të Ligjit Për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), Ligjit Për Përdorimin e Gjuhëve Nr. 02/L-37 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 10/2007) dhe nenit 8, të Statutit të Komunës së Junikut (001. Nr. 696/2008 i datës 27. Nëntor 2008), Kuvendi i Komunës së Junikut në mbledhjen e mbajtur më: 28.07.2009, miratoi këtë:

RREGULLORE PËR PËRDORIMIN E GJUHËVE

PJESA E PARË Dispozitat e përgjithshme

Neni 1

Më këtë rregullore dhe në pajtim më Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve, rregullohen kushtet e përdorimit të barabartë të gjuhëve dhe shkrimeve si dhe sigurohet zbatimi i barabartë i tyre në institucionet komunale të Komunës së Junikut.

Neni 2

2.1. Qëllimi i kësaj rregulloreje është që të sigurojë:

- 2.1.1. Përdorimin e gjuhëve zyrtare, si dhe të gjuhëve të komuniteteve, gjuha amtare e të cilave nuk është gjuhë zyrtare në Komunën e Junikut;
- 2.1.2. Status të barabartë kanë Gjuha Shqipe dhe Gjuha Serbe si gjuhë zyrtare në Kosovë, të drejta të barabarta sa i përket përdorimit të tyre në të gjitha institucionet komunale;
- 2.1.3. Të gjitha komunitetet e Komunës së Junikut, kanë të drejtë për të ruajtur, mbrojtur dhe promovuar identitetin e tyre gjuhësor sipas kushteve të përcaktuara me Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve..

Neni 3

Të gjitha komunitetet kanë të drejta të barabarta në lidhje me përdorimin e gjuhëve në institucionet komunale.

Neni 4

4.1. Çdo person ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë për të pranuar, kërkuar dhe për të dhënë informata dhe ide në gjuhën e zgjedhur, pa ndonjë ndikim.

4.2. Çdo person ka të drejtën për barazi para ligjit dhe të mbrojtjes së barabartë nga ligji. Ndalohet çdo diskriminim në baza gjuhësore.

PJESA E DYTË

Dispozitat e veçanta

Përdorimi i gjuhëve në institucionet komunale

Neni 5

5.1. Në të gjitha institucionet komunale zbatohet barazia e gjuhëve zyrtare të komunës. Gjuhë zyrtare në Komunën e Junikut është gjuha shqipe dhe gjuhët tjera të përcaktuara sipas Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve .

5.2. Çdo person ka të drejtë të komunikojë dhe të pranojë shërbimet e mundshme dhe dokumentet publike nga institucionet komunale dhe nga zyrtarët në cilëndo gjuhë zyrtare ata kërkojnë.

5.3. Gjuhët zyrtare përdoren në baza të barabarta në takime dhe në punën e organeve përfaqësuese dhe ekzekutive komunale, institucionet komunale do të mundësojnë përkthimin nga një gjuhë zyrtare në tjetrën nëse kjo kërkohet.

5.4. Anëtarët e Ekzekutivit, Kuvendit dhe komiteteve, kanë të drejtë të përdorin gjuhën amtare në takime të institucioneve lokale dhe takime publike të organizuara nga këto institucione .

5.5. Shënimet dhe dokumentet zyrtare do të mbahen në gjuhët zyrtare dhe në gjuhën e komunitetit.

5.6. Emrat zyrtarë të institucioneve dhe të organeve komunale paraqiten në gjuhët zyrtare (sipas Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve).

5.7. Shenjat zyrtare që shënojnë apo përfshijnë emrat e komunave, fshatrave, rrugëve, rrugicave dhe të vendeve tjera publike, paraqiten në gjuhët zyrtare, gjuha e të cilave ka statusin e gjuhës zyrtare në komunë, në pajtueshmëri me nenin 2.3 të Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve.

5.8. Ueb faqja e Komunës së Junikut mbahet në gjuhët zyrtare të Komunës (Shqip, Anglisht, Serbisht).

Neni 6

6.1. Gjuhët zyrtare përdoren në baza të barabarta nga pjesëtarët e etnitetit, në punë, në debate dhe në procedura tjera të Kuvendit Komunal, komiteteve të tij nga pjesëtarët e komuniteteve të ndryshme. Institucionet komunale do të sigurojnë përkthim simultan

nga një gjuhë zyrtare në tjetrën për debate që zhvillohen në Kuvendin Komunal dhe komitetet e tij dhe takimet tjera të organizuara nga komuna nëse e kërkon nevoja.

6.2. Anëtarët e Ekzekutivit, Kuvendit dhe Komiteteve të tij, gjuha amtare e të cilëve nuk është gjuhë zyrtare kanë të drejtë të përdorin gjuhën e tyre amtare në punë dhe në takime që organizohen nga Komuna e Junikut.

6.3. Dokumente zyrtare si dhe të dhënat zyrtare të debateve, nxirren dhe publikohen në gjuhën shqipe dhe në gjuhët e komunitetit sipas nevojë.

Neni 7

Rregulloret dhe aktet tjera të miratuara nga institucionet komunale nxirren dhe publikohen në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të komunitetit pakicë të komunës.

Neni 8

Personat të cilët iu takojnë komuniteteve, gjuha e të cilëve është në përdorim zyrtar, kanë të drejtë të paraqesin të gjitha kërkesat dhe dokumentet në formë të shkruar apo gojore, si dhe të pranojnë përgjigjet në gjuhët e tyre nga institucionet dhe nga zyrtarët komunal, nëse ata kërkojnë kështu.

Përdorimi i gjuhëve zyrtare në institucionet arsimore komunale

Neni 9

9.1. Çdo person ka të drejtë të regjistrohet si dhe të regjistrojë fëmijët e vetë në shkollën ku gjuha e tij e zgjedhur zyrtare është si gjuhë mësimi në atë institucion (neni 19, 19.3 i Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve).

9.2. Prindi apo personi tjetër që përkujdeset për fëmijët ka të drejtë të zgjedhë gjuhën e vetë të preferuar zyrtare për mësim (neni 19, 19.2. i Ligjit për Përdorimin e gjuhëve).

Emrat personal

Neni 10

10.1. Emri dhe mbiemri i personit regjistrohet në librat publik, në dokumente për identifikim personal dhe dokumente të tjera zyrtare në sistemin me shkrim në gjuhën zyrtare të zgjedhur nga aji person.

10.2. Personat që i takojnë komunitetit, gjuha amtare e të cilit nuk është gjuhë zyrtare, do të kenë të drejtën të regjistrojnë formën origjinale të emrit dhe mbiemrit të tyre në shkrimin dhe në pajtueshmëri me traditat dhe sistemin linguistik të gjuhës së tyre, si në

regjistrat publikë, në dokumente për identifikim personal dhe në dokumente të tjera zyrtare , si dhe kjo formë do të përdoret nga zyrtarët publik.

Zbatimi

Neni 11

11.1. Komuna e Junikut dhe institucionet e saj do të respektojnë masat për përdorimin e lirë të gjuhëve, dhe do të zbatoj përdorimin e gjuhëve të komuniteteve, gjuha amtare e të cilëve nuk është gjuhë zyrtare.

11.2. Kryetari i Komunës do të siguroj monitorimin e kësaj rregulloreje.

Neni 12

Sanksionet administrative që do të shqiptohen institucioneve publike të cilat bëjnë shkelje të dispozitave të ligjit për përdorim të gjuhëve, do të shqiptohen sipas UA, Nr. 2007/1 –MSHP.

PJESA E TRETË

Dispozitat kalimtare dhe të fundit

Neni 13

Në rast se ekziston ndonjë konflikt midis dispozitave të rregullores me dispozitat e Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve, dispozitat e Ligjit do të jenë të aplikueshme.

Neni 14

Kjo rregullore hynë në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës Junik.

KUVENDI KOMUNAL JUNIK

**Kryesuesja e Kuvendit Komunal,
Znj. Zelfisha Shala**

Datë: 28.07.2009

Nr: -----